



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 684, datë 14.11.2023**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.*

### 1.A. NJOHURITË LIGJORE

#### 1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, të cilët do të përcaktojnë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë, edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e çështjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit

*{...} identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore. Ai e analizon normën penale në raport me rrethanat konkrete të mosmarrëveshjes dhe nxjerr konkluzione mbi çështjen nga zbatimi i saj. Ai ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve penale...Në zgjidhjen e çështjeve, i kushton rëndësi pretendimeve të palëve, përcakton faktin penal, duke treguar provat që e mbështesin atë, analizon në mënyrë të plotë elementët e veprës penale dhe i kushton rëndësi të posaçme identifikimit të llojit dhe të masës së dënimit, duke përshkruar të gjithë treguesit që kanë rëndësi për çështjen. Në varësi të rrethanave të çështjes, diferencon llojin e dënimit kryesor me burgim (shih dokumentet 2, si dhe dosjet 1, 2, 3 dhe 4) analizon nëse është rasti për caktimin e dënimeve plotësuese (shih dokumentin 3 dhe dosjen 5), si dhe analizon nëse ka vend për alternativat e dënimit me burgim (shih dosjet 1, 2 dhe 3). Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit {...} për gjykimin e shkurtuar ka referencë vetëm në dispozitën e K.Pr.Penale dhe nuk referon edhe në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë (shih dokumentat 1 dhe 2 dhe dosjet 2, 3 dhe 4). Vetëm në dy raste ka përdorur jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentat 1 dhe 3)”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

***- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik penal vjen gjithmonë i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes, pothuajse në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, vlen të theksohet se pavarësisht llojit të gjykimin të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale apo kërkesë penale-mosfillim i procedimit penal*), rrethanat e fakteve parashtrohen në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, pas parashtrimit të rrethanave procedurale.

Pavarësisht se nga ana e gjyqtarit nuk rezulton që faktet të pasqyrohen në një nën-pjesë të titulluar në mënyrë eksplicite si “Rrethanat e faktit”, mënyra se si ato janë përshkruar në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve, i bëjnë ato lehtësisht të dallueshme dhe të kuptueshme për lexuesin.

Në vendimet e themelit gjyqtari, nxjerr faktet e provuara nga tërësia e provave të administruara në gjykim duke përshkruar fillimisht kronologjinë e ngjarjes gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal, si dhe veprimet e kryera nga i pandehuri, duke i integruar provat mbi të cilat mbështeten faktet. Elementë të faktit penal bëhen pjesë e analizës së elementëve të figurës së veprës penale në pjesën e analizës dhe vlerësimit të gjykatës, duke i kushtuar një

rëndësi specifike paraqitjes dhe listimit të fakteve thelbësore mbi të cilat mbështetet analiza e provave dhe kualifikimi ligjor.

***-Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës çështja i është paraqitur gjykatës për shqyrtim, ku në rastin konkret, të gjitha vendimet burim vlerësimi janë çështje penale themeli ose kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak. Gjyqtari pas përcaktimit të natyrës së çështjes, përcakton drejt llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, apo institutin procedural të kundërshtimit të vendimeve të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal.

Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes del qartë, edhe kur nuk është identifikuar në mënyrë specifike, referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

***-Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Duke qenë se burim vlerësimi janë vetëm vendimet që i përkasin kategorisë së çështjeve penale (*themeli apo kërkesë penale*), konstatohet se gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal.

- Konkretisht, gjyqtari identifikon në funksion të cilësimit juridik të faktit penal nenin 79/dh të K.Penal në lidhje me veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, kundër dy ose më shumë personave dhe nenin 278 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”;<sup>1</sup> nenin 130/a/1 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje”;<sup>2</sup> neni 100/1 të K.Penal në lidhje me akuzën “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”;<sup>3</sup> nenin 248 të K.Penal në lidhje me veprën penale të “Shpërdorimi i detyrës”;<sup>4</sup> nenin 134 të K.Penal në lidhje me veprën penale të “Vjedhjes”;<sup>5</sup> nenin 140 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Vjedhje me armë”;<sup>6</sup> nenin 291 të K.Penal në lidhje me akuzën për

<sup>1</sup>Vendimi nr.1416, datë 05.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>2</sup>Vendimi nr.2534, datë 07.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>3</sup>Vendimi nr.582, datë 25.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>4</sup>Vendimi nr.1822, datë 26.12.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>5</sup>Vendimi nr.783, datë 17.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>6</sup>Vendimi nr.2646, datë 13.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”;<sup>7</sup> nenin 283/1 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”;<sup>8</sup> nenin 290/2 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”,<sup>9</sup> dhe nenin 137/1 të K.Penal në lidhje me akuzën “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”.<sup>10</sup>

- Në ato raste kur për cilësimin juridik të veprës penale që i atribuohet të pandehurit dhe me qëllim përcaktimin e përgjegjësisë penale të tij, nevojitet referimi në ligje të tjera organike, identifikohet ligji organik përkatës. Konkretisht, në analizën e anës objektive të figurës së veprës penale të “Drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt”, duke qenë se kjo është një dispozitë *blankete*, gjyqtari referon nenin 115 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.<sup>11</sup> Po ashtu, në analizën e anës objektive të veprës penale “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, gjyqtari në funksion të analizës se veprimet ose mosveprimet e të pandehuri kanë qenë në kundërshtim me ligjin, referon ligjin nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, ligjin “Për kontabilitetin”, si dhe aktet normative të dala në zbatim të tyre;<sup>12</sup>
- Në çdo rast referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh. në lidhje me moshën për përgjegjësi penale (neni 12 i K.Penal), kriteret dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (neni 47 i K. Penal),<sup>13</sup> rrethanat lehtësuese dhe rënduese (nenet 48, 49 dhe 50 të K. Penal), dispozitat lidhur me dënimet alternative (nenet 59 dhe 60 të Kodit Penal),<sup>14</sup> etj.

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme të përmendur më sipër, në një rast gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe akte ndërkombëtare (Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijëve”) që përbëjnë burim të së drejtës, në lidhje me mbrojtjen e posaçme të vendosur nga shteti për zhvillimin normal të shëndeti mendor dhe fizik të fëmijëve.<sup>15</sup>

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtari ka referuar në çdo rast, si pjesë e integruar e arsyetimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal, si më poshtë:

<sup>7</sup>Vendimet nr.2738, datë 13.11.2014 dhe nr.1678, datë 12.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>8</sup>Vendimet nr.3275, datë 23.12.2014 dhe nr.71, datë 19.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>9</sup>Vendimi nr.2388, datë 17.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>10</sup>Vendimi nr.2213, datë 19.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>11</sup>Vendimet nr.2738, datë 13.11.2014 dhe nr.1678, datë 12.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>12</sup>Vendimi nr.1822, datë 26.12.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>13</sup>Këto dispozita referohen në të gjitha vendimet penale të themelit

<sup>14</sup>Vendimet nr.1822, datë 26.12.2013, nr.3275, datë 23.12.2014, nr.1822, datë 26.12.2013, nr.71, datë 19.01.2016, nr.2534, datë 07.07.2015, nr.783, datë 11.04.2014, nr.2213, datë 19.06.2015, nr.1678, datë 12.12.2013 dhe nr.2738, datë 13.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>15</sup>Vendimi nr.582, datë 25.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 406 të K.Pr.Penale lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me këtë lloj të posaçëm gjykimi;
- nenet 151 dhe 152 të K.Pr.Penale në lidhje me çmuarjen e provave dhe vlerën e tyre provuese, nenin 388/d të K.Pr.Penale në rastin e deklarimit të pafajshëm të autorit, për shkak se nuk provohet që vepra penale që i atribuohet të pandehurit të jetë kryer prej tij dhe 389 të K.Pr.Penale lidhur me disponimin e gjykatës për shuarjen e masës së sigurimit, në kushtet e vendimmarrjes së pafajësisë për të pandehurin;<sup>16</sup>
- dispozitat lidhur me marrjen dijeni për veprën penale (nenet 284, 285 dhe 287 të K.Pr.Penale), në funksion të analizës së këto dispozita nuk parashikojnë mundësinë e tërheqjes së ankimit për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal;<sup>17</sup>
- nenet 58, 59 dhe 60 të K.Pr.Penale në lidhje të drejtat e të dëmtuarit akuzues, të akuzuarin dhe elementet që duhet të përmbajë kërkesa për gjykimin e të dëmtuarit akuzues, në të kundërt ajo është pavlefshme;<sup>18</sup>
- nenin 190 të K.Pr.Penale në lidhje me provat materiale dhe nenin 485 të K.Pr.Penale lidhur me shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore në procesin penal;
- nenin 97/3 të K.Pr.Penale në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së caktuar nga Gjykata e Lartë për të filluar çështjen nga fillimi.<sup>19</sup>

Në vendimin me objekt kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal,<sup>20</sup> gjyqtari identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizës së ligjshmërisë së vendimit të organit të akuzës (*nenin 291 e vijues të K.Pr.Penale*).

***Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave***, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast konflikt i normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsyetimit lidhur me zgjidhjen e çështjes.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes, analizën dhe vlerësimin individual të tyre, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete.

<sup>16</sup>Vendimi nr.582, datë 25.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>17</sup>Vendimi nr.2534, datë 07.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>18</sup>Vendimi nr.53 akti, datë 23.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>19</sup>Vendimi nr. 1416, datë 05.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>20</sup>Vendimi nr. 497, datë 08.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES**

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke i dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’u japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Në zgjidhjen e çështjeve, i kushton rëndësi pretendimeve të palëve, përcakton faktin penal, duke treguar provat që e mbështesin atë, analizon në mënyrë të plotë elementët e veprës penale dhe i kushton rëndësi të posaçme identifikimit të llojit dhe të masës së dënimit, duke përshkruar të gjithë treguesit që kanë rëndësi për çështjen. Në varësi të rrethanave të çështjes, diferencon llojin e dënimit kryesor me burgim (shih dokumentet 2, si dhe dosjet 1, 2, 3 dhe 4) analizon nëse është rasti për caktimin e dënimeve plotësuese (shih dokumentin 3 dhe dosjen 5), si dhe analizon nëse ka vend për alternativat e dënimit me burgim (shih dosjet 1, 2 dhe 3). Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit {...} për gjykimin e shkurtuar ka referencë vetëm në dispozitën e K.Pr.Penale dhe nuk referon edhe në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë (shih dokumentat 1 dhe 2 dhe dosjet 2, 3 dhe 4). Vetëm në dy raste ka përdorur jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentat 1 dhe 3)...”.

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:**

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të

fakteve objekt akuze dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale, ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarit është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretimin e tyre në mënyrë abstrakte, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur.

**- Në drejtim të interpretimit të ligjit material të zbatueshëm:**

Në vendimet penale të analizuara, duke iu referuar natyrës së çështjes, e cila përcakton edhe elementët që duhet të analizohen në aspektin e provueshmërisë së faktit penal, gjyqtari interpreton normën përkatëse të Kodit Penal, në mënyrë abstrakte duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e figurës së veprës penale konkrete. Gjyqtari interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj.

Në mënyrë më specifike, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari interpreton dispozitat materiale (*nenet 248, 291, 100/1, 79/dh, 278/2, 283/1, 130/a/1, 134/1, 300, 290/2, 137, 140 të Kodit Penal*) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet. Gjyqtari interpreton në nivel teorik normën relevante të K.Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, dhe në vijim, duke e përjasur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit. Dispozitat e kodit penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale, duke u përqendruar më tepër në anën objektive dhe subjektive të saj.<sup>21</sup>

Gjithashtu, konstatohet jo vetëm identifikimi, por edhe interpretimi i ligjeve të posaçme në ato raste kur dispozita penale materiale ku të referon fakti penal është një dispozitë *blanket*, si p.sh. në vendimin nr.2738, datë 13.11.2014 dhe vendimin nr.1678, datë 12.12.2013 duke qenë një dispozitë e bardhë (neni 291 i K.Penal) është referuar në dispozitat e Kodit Rrugor, nenet 53 dhe 115 të tij, ose në vendimin nr.1822, datë 26.12.2013 në të cilën gjykata për të përcaktuar anën objektive të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” i referohet akteve ligjore dhe nënligjore, që normojnë punën e personit që ushtron funksione publike dhe konkretisht ligjin nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, ligjin “Për kontabilitetin”, si dhe aktet normative të dala në zbatim të tyre.

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast,

---

<sup>21</sup>Konstatohet ky interpretim në të gjitha vendimet penale burim vlerësimi



gjyqtari interpreton dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*) ose aplikimin apo jo të alternativave të dënimit (*neni 59 të K.Penal*). Në këto raste, gjyqtari ndalet kryesisht në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri nga një dënimit alternativ, siç është ai i parashikuar në nenin 59 i Kodit Penal. Gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë individualizimit të dënimit duke analizuar të gjitha rrethanat lehtësuese/rënduese që lidhen si me rrezikshmërinë e veprës penale, ashtu edhe me rrezikshmërinë e autorit në çdo rast, për të argumentuar pas kësaj analize të detajuar edhe konkluzionin në lidhje me caktimin e dënimit. Në të gjitha vendimet penale të themelit, për të mbështetur argumentimin mbi masën e dënimit, lidhur me llojin dhe masën e dënimit, gjyqtari përcakton rrethanat që merren në konsideratë në caktimin e dënimit, duke i aplikuar ato mbi rastin konkret, në mbështetje të vlerësimit për përshtatshmërinë e masës së dënimit.

**- Në drejtim të interpretimit të dispozitave procedurale**

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale penale, gjyqtari i jep rëndësi më shumë zbatimit të normës, sesa interpretimit të saj. Gjyqtari i ka kushtuar rëndësi interpretimit të normës, në drejtim të zgjidhjes së situatave procedurale, të iniciuara nga palët (*kërkesat e palëve*), të iniciuara kryesisht, ose si domosdoshmëri e procesit të të provuarit. Konkretisht, konstatohet se gjyqtari: (i) interpreton nenin 97/3 të K.Pr.Penale në lidhje vlerësimin për fillimin nga e para të procesit gjyqësor, pa u dhënë efekt veprimeve të kryera nga gjykata prej të cilës është transferuar çështja penale,<sup>22</sup> (ii) interpreton nenet 59 dhe 60 të K.Pr.Penale në lidhje me të drejtën e të dëmtuarit akuzues për të investuar gjykatën nëse është cënuar në një nga veprat penale të parashikuar në këtë nen, si dhe pasojën në rast të mos paraqitjes në gjykim të të dëmtuarit akuzues. Kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, gjyqtari interpreton nenin 329 të K.Pr.Penale lidhur me ankimin kundër vendimit të pushimit të akuzës/çështjes, në mbështetje të të cilit gjyqtari referon edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*vendimin nr. 2, datë 19.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*) dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese (*vendimin nr. 14, datë 21.07.2008*).<sup>23</sup>

**- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante**

Në vendimet burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese*), në mbështetje të argumenteve për interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht:

---

<sup>22</sup>Vendimi nr.1416, datë 05.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>23</sup>Vendimi nr.497, datë 08.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- vendimin unifikues nr. 3/2002, të Gjykatës së Lartë, në lidhje me parimin procedural “tejt çdo dyshimi të arsyeshëm”;<sup>24</sup>
- vendimin unifikues nr.2, datë 20.06.2013, të Gjykatës së Lartë, në lidhje me gjykimin e ankimit kundër vendimit të prokurorit për mosfillim, i cili nuk kërkon një shqyrtim gjyqësor të ndërlikuar por ai mund të bëhet edhe vetëm mbi bazë shqyrtimit të dokumenteve (*de plano*); vendimin nr.14, datë 21.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr.492, datë 16.12.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, lidhur me detyrimin e gjykatës për të verifikuar vetëm nëse organi i akuzës ka zbatuar parimin e ligjshmërisë, nëse ka zhvilluar hetime të plota dhe të gjithanshme por kurrësi të urdhëroj këtë organ për të ushtuar ndjekje penale;<sup>25</sup>
- konstatohet se ndryshe nga sa është konkluduar në raportin analitik të përgatitur për organet e rivlerësimit kalimtar, në vendimet penale burim vlerësimi edhe pse nuk është bërë në mënyrë specifike identifikimi i vendimit unifikues nr. 2 datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pranimit apo jo i kërkesës për gjykimin e shkurtuar është bërë duke u bazuar në konkluzionet e arritura të vendimit unifikues e në këtë kontekst, rezulton të jetë zbatuar drejtpërsëdrejti ky vendim në të gjitha vendimet burim vlerësimi.
- vendimin unifikues nr. 1, datë 27.03.2008, e Gjykatës së Lartë në lidhje me përcaktimin e “*dozës së vogël*” për efekt të përgjegjësisë penale për mbajtjen e lëndës narkotike, etj.<sup>26</sup>

**- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës**

Nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i përhershëm i gjyqtarit që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtari i njëj, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimi prezumimit të pafajësisë*, sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale, në nenin 30 të Kushtetutës, dhe parimin procedural penal që ka lidhje të drejtpërdrejtë me përgjegjësinë penale të autorit “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”;<sup>27</sup>
- *Parimin e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i referuar dhe po ashtu i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit;
- *Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit*. Në caktimin e masës së dënimit gjykata ka analizuar parimet kryesore të dënimit penal si një masë shtrënguese kundër personit fajtor që ka kryer veprë penale, *si parimin e ligjshmërisë, individualizimit të dënimit, të dobishmërisë së dënimit dhe të përshtatshmërisë së dënimit (proporcionalitetit)* sipas nenit 47 dhe 47/2 të K.Penal, etj.

<sup>24</sup>Vendimi nr.582, datë 25.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>25</sup>Vendimi nr.497, datë 08.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>26</sup>Vendimi nr.3275, datë 23.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

<sup>27</sup>Vendimi nr.582, datë 25.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

## KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Parimet e përdorura në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e së drejtës, integrohen në arsyetim në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### 1.B. ARSYETIMI LIGJOR

#### 1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit {...} janë të qarta, të plota dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është organizuar sipas kërkesave të legjislacionit procedural penal. Ai bën pjesë të arsyetimit të vendimit çështjet procedurale lidhur me gjykimin e shkurtuar, por përgjithësisht nuk bën pjesë të arsyetimit të vendimit edhe çështje procedurale mbi juridiksionin gjyqësor, kompetencat lëndore e tokësore. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjyqimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, nuk rezulton përdorimi i termave latine,<sup>28</sup> por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit, apo si pasojë e referimit në ligje të posaçme me karakter specifik, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsytimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në çështjen penale që lidhet me veprën penale të “Dhunës në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, evidentohet kujdesi i gjyqtarit për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, ku, për shkak të natyrës së veprës, terminologjia e përdorur nga palët mbart ngarkesë emocionale që diktohet nga qëndrimi subjektiv dhe ngushtësisht personal i subjekteve në raport me perceptimin e faktit penal.<sup>29</sup>

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsytimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura, të kuptueshme dhe të organizuara në mënyrë të rregullt nga pikëpamja strukturore dhe e sintaksës. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët dhe pjesët në të cilat është organizuar arsytimi po ashtu, duke ndjekur strukturën e vendimit gjyqësor. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Arsytimi është i organizuar me paragrafë dhe në pjesë, duke kaluar mendimin nga njëri paragraf në tjetrin në mënyrë të natyrshme dhe nga njëra pjesë në tjetrën po ashtu.

Evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë të shkrimit dhe arsytimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit dhe rrjedhshmërisë së paraqitjes së arsytimit ligjor.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Zgjedhja dhe përdorimi i fjalëve, organizimi i tyre në fjali

---

<sup>28</sup>Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

<sup>29</sup>Vendimi nr.2534, datë 07.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

dhe më tej, grupimi i fjalive në paragrafët e vendimit, lejon një lexim të organizuar. Kjo mënyrë e shkrimit ligjor, evidenton aftësinë e gjyqtarit për të gjetur balancë mes të shprehurit thjesht dhe qartë dhe renditjes të argumentimit ligjor sipas një rrjedhe logjike të kuptueshme.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

### **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT**

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Pjesa hyrëse e vendimit është e plotë, me të gjitha elementët e kërkuar nga ligji.... Dispozitivi i vendimit

*hartohet prej tij në mënyrë të plotë dhe është rrjedhojë e pjesës arsyetuese të vendimit. Aty disponohet rregullisht mbi fajësinë e të pandehurit, llojet e dënimit dhe masat, si dhe mbi veprimet dytësore që lidhen me vuajtjen e dënimit, provat materiale dhe shpenzimet procedurale. Vetëm në një rast është dhënë pafajësi, për të cilën nuk ka të dhëna në lidhje me vlerësimin ligjor të vendimit nga gjykatat më të larta (shih dokumenti 1). Në një rast është vendosur rrëzimi i kërkesës së të dëmtuarit akuzues dhe vlerësimi ligjor i këtij vendimi është konsideruar i drejtë nga gjykata e apelit, e cila ka lënë në fuqi vendimin (shih dosja 5). Në dispozitivin e vendimit përgjithësisht disponohet për shpenzimet gjyqësore, por në një rast kur ato janë bërë pjesë e arsytimit të vendimit kanë qenë kontradiktore me disponimin e gjykatës në dispozitivin e vendimit (shih dokumenti 1). Gjithashtu konstatohet se përgjithësisht në dispozitivin e vendimit tregohet qartësisht e drejta dhe afati i ankimit...”.*

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i referohet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë si pasojë e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

*Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti i shqyrtimit, akuza ndaj të pandehurit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.*

*Pjesa përshkuese-arsyetuese e vendime gjyqësore është e ndarë në disa pjesë, në të cilat në mënyrë të detajuar gjyqtari paraqet:*

- (i) Rrethanat procedurale. Në këtë nënpjesë (edhe pse jo një nënpjesë e titulluar rrethanat procedurale ajo del nga analiza dhe parashtrimi i çështjeve dhe kërkesave me natyrë procedurale dhe jo të thelbit) gjyqtari ka renditur elementët thelbësorë procedurale të ecursisë së gjykimit, si: pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar, zhvillimit të gjykimit në mungesë të të pandehurit, etj.;*
- (ii) Faktet e çështjes, në rend logjik e kronologjik, përgjithësisht të integruara me provat (në prezantimin e fakteve përgjithësisht gjyqtari bën një lidhje të provave me faktin penal të evidentuar), por edhe duke i listuar provat në ato raste kur procedohet me gjykim të shkurtuar.*
- (iii) Analizën ligjore, e cila organizohet duke filluar me referimin e ligjit material të zbatueshëm, zbërthimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale konkrete dhe përjasjen e tyre me faktin penal të provuar në gjykim, për të vijuar me konkluzionin mbi ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit, dhe më tej me analizën lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit.*

*Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me deklarin e pafajshëm të të pandehurit, apo dënimin e tij (sipas rastit), masën e dënimit të të pandehurit, aplikimin e gjykimit të shkurtuar, mënyrën e vuajtjes së dënimit, shpenzimet gjyqësore dhe hetimore, e drejta e ankimit, si dhe vendi dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se të gjithë vendimet përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale.*

Vendimet janë të strukturuar në paragrafë të cilët shpesh fillojnë me fjali tematike ose përmbillen me fjali përmbledhëse në formën e konkluzionit, duke theksuar konkluzionin e arritur nga gjyqtari si pasojë logjike e arsyetimit. Gjyqtari ndjek rregulla të qarta dhe përgjithësisht të njëjta në strukturimin e vendimit gjyqësor, duke zbatuar në çdo rast rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor, përgjithësisht referuar metodës IRAC, duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe konkluzionin e arritur.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit. Ai zbaton rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe i kushton vëmendje ndjekjes së një strukture të njëjtë në organizimin e vendimit, e cila paraqitet e qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e rrjedhshmërisë logjike. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecuresë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK**

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës: tregon pretendimet e palëve dhe arsytet përse nuk pranohen pretendimet e kundërta, faktin e përcaktuar nga gjykata, provat e pranuar dhe arsytet përse nuk besohen provat e kundërta, nenet e shkelura të ligjit, analiza ligjore e tyre, faktorët që janë marrë në konsideratë për llojin dhe masën e dënimit, arsytet mbi disponimin për provat materiale, por nuk bën identifikimin konkret të shpenzimeve procedurale. Në tekstet e vendimit (me përjashtim të një çështje-dokumenti 1, ku në pjesën arsyetuese të vendimit dhe dispozitivit të vendimit ka vlerësim kontradiktor), ekziton lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Aftësia e tij arsyetuese është konfirmuar edhe nga gjykatat më të larta. Janë ankimuar 3 prej tyre. Në dy raste, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit (shih dosjet 1 dhe 5) dhe në një rast është lënë në fuqi vendimi me ndryshim, duke aplikuar nenin 59 të K. Penal (shih dosja 4)”.

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuar rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i detajuar, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale (procedimit me gjykim të shkurtuar).

Në vendimet burim vlerësimi, karakteristikë e gjyqtarit është veçimi dhe analiza e detajuar e fakteve esenciale që kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet, autorësisë së saj, paraqitjes së provave në lidhje me secilin fakt, duke lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila provë në shërbim të provueshmërisë së tij, duke evidentuar qartë dhe në mënyrë të natyrshme lidhjen shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurve, në raport me faktin penal të provuar.

Në çdo rast, interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, kryesisht në drejtim të :

- (i) figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet dhe elementëve e saj si dhe autorësisë e të pandehurit;<sup>30</sup>
- (ii) ecurisë procedurale të gjykimit në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar, apo në rastin kur çështja është transferuar me vendim të gjykatës së lartë nga një gjykatë tjetër;<sup>31</sup>
- (iii) analizës lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore te individualizimit të dënimit;

---

<sup>30</sup>Në të gjitha vendimet penale të themelit, gjyqtari ndalet në analizën e elementëve të figurës së veprës penale dhe përjashten e faktit të provuar në raport me to, në funksion të vlerësimit të tij mbi cilësimin juridik të faktit penal për të cilin procedohet

<sup>31</sup>Vendimi nr.1416, datë 05.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë



(iv) aplikimit të alternativave të dënimit me burgim duke u ndalur në analizën e qëllimit të aplikimit të tyre në raport me arritjen e qëllimit të dënimit penal apo zbatimin e parimit të caktimit të dënimit në mënyrë të drejtë dhe proporcionale.

*Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjyqimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal, për llojin dhe masën e dënimit, etj). Pretendimet merren në shqyrtim dhe analizohen jo në një pjesë të veçuar të arsytimit, por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret. Pretendimet e palëve kanë marrë gjithmonë një përgjigje të argumentuar dhe janë analizuar plotësisht, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme, si pjesë e arsytimit tërësor.*

## KONKLUZIONI

Në tërësi, në të gjitha vendimet e gjyqtarit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të vetë zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarit në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, duke pasuruar arsytimin e vetë gjyqtarit. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve, apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

#### 2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, nuk ka të dhëna.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar vetëm 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, pa përfshirë tre vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për asnjë prej tyre nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

#### **KONKLUZIONI**

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër, në të cilat nuk parashikohet ndonjë afat

ligjor për përfundimin e tyre, aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

## **2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short konstatohet se 1 çështje është gjykuar jashtë afatit standart të Sistemit të Vlerësimit dhe konkretisht në intervalin kohor 2 vjet e 2 muaj (shih dosja 1) dhe 4 çështjet janë gjykuar nga gjyqtari {...} brenda afateve standard të Sistemit të Vlerësimit dhe konkretisht në intervale kohore 1 muaj e 14 ditë (shih dosjen 2), 2 muaj e 12 ditë (shih dosjen 3), 3 muaj e 12 ditë (shih dosjen 4) dhe 1 muaj e 6 ditë (shih dosjen 5). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit prej 2 vjet e 2 muaj, ka qënë çështje penale për krimin e shpërdorimit të detyrës, e shqyrtuar me procedurën e gjykimit të zakonshëm në 47 seanca gjyqësore dhe në përfundim është disponuar me vendim penal dënimi 1 vit burgim, duke aplikuar nenin 59 të K.Penal vendim, i cili është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 291, datë 03.03.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1822, datë 26.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Aktualisht çështja është për shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe deri në momentin e hartimit të këtij raporti nuk është gjykuar me vendim përfundimtar. Kohëzgjatja e gjykimit nuk është analizuar edhe tek 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, pasi nga të dhënat e vendimit nuk identifikohet data e regjistrimit të çështjes në gjykatë”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, pa përfshirë vendimet e

zgjdhura nga gjyqtari, në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur përgjithësisht brenda standardeve minimale kohore, ku referuar Vendimit nr.261/2 të KLD, duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezultton:

Çështje penale- kategoria krime:

- Dosja 1 - (është regjistruar në datën 26.10.2011 (nuk ka të dhëna lidhur me datën e caktimit të çështjes me short) dhe ka përfunduar në datën 26.12.2013) Gjykimi ka zgjatur 791 ditë, tej afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 2 - (është caktuar me short në datën 30.10.2013 dhe ka përfunduar në datën 12.12.2013) Gjykimi ka zgjatur 43 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 3 - (është caktuar me short në datën 01.09.2014 dhe ka përfunduar në datën 13.11.2014) Gjykimi ka zgjatur 73 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 4 - (është caktuar me short në datën 02.09.2014 dhe ka përfunduar në datën 23.12.2015) Gjykimi ka zgjatur 112 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 6 - (është caktuar me short në datën 11.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 17.10.2014) Gjykimi ka zgjatur 128 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 7 - (është caktuar me short në datën 20.01.2014 dhe ka përfunduar në datën 11.04.2014) Gjykimi ka zgjatur 81 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 8 - (është caktuar me short në datën 18.05.2015 dhe ka përfunduar në datën 19.06.2015) Gjykimi ka zgjatur 32 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 9 - (është caktuar me short në datën 07.04.2015 dhe ka përfunduar në datën 07.07.2015) Gjykimi ka zgjatur 91 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 10 - (është caktuar me short në datën 27.06.2016 dhe ka përfunduar në datën 13.09.2016) Gjykimi ka zgjatur 78 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 11 - (është caktuar me short në datën 16.11.2015 dhe ka përfunduar në datën 19.01.2016) Gjykimi ka zgjatur 64 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

Çështje penale- kategoria kundërvajtje:

- Dosja 5 - (është caktuar me short në datën 18.02.2016 dhe ka përfunduar në datën 23.03.2016) Gjykimi ka zgjatur 33 ditë, brenda afatit 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë kundërvajtje).

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, të 11 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër referohet më sipër, vetëm 1 (një) prej tyre ka përfunduar tej standardit minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së, ose rreth 9% e çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor.

#### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se numri i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, është 9%.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari bazuar në Metodologjinë e Pikëzimit, pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej standardit minimal, është 9%.*

#### **2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...}, vetëm në dy raste i ka kushtuar rëndësi arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke i arsyetuar shpejt ato dhe brenda afateve ligjore dhe në tre raste vendimet janë arsyetuar jashtë afatit ligjor. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 15 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), duke vënë në vështirësi të pandehurën për të paraqitur ankim (në dosje është apelimi paraprak për zënie afati paraqitur nga e pandehura A. Arifaj më datë 08.01.2014), për 5

*ditë nga shpallja (shih dosjen 2), për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 3), për 6 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe për 12 ditë nga shpallja (shih dosjen 5)”.*

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, pa përfshirë vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*11 çështjet e marra në analizë, i përkasin kategorisë së çështjeve penale themeli-krime dhe penale themeli-kundërvajtje*), rezultojnë se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 10 (dhjetë) çështje në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezultojnë të jetë 149 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale krime në gjykatën e shkallës së parë.<sup>32</sup>
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Penale kundërvajtje”, rezultojnë të jetë 33 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale kundërvajtje në gjykatën e shkallës së parë.<sup>33</sup>

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

---

<sup>32</sup>Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ *a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm*”.

<sup>33</sup>Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ *a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm*”.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

## **2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...}, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dhomën penale. Ai ka deklaruar se në tre vitet e fundit 2014, 2015 dhe 2016, atij i janë caktuar gjithsej 1.167 çështje gjyqësore, ka përfunduar 791 çështje gjyqësore dhe ka mbartur 22 çështje gjyqësore në vitin 2017. Nga të dhënat statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtari {...} ka përfunduar gjithsej 811 çështje gjyqësore, nga të cilat 558 çështje penale, 231 kërkesa penale dhe 22 kërkesa penale me të dëmtuar akuzues. Sipas pikës 3 shkronja “e”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje penale). Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasimore prej jo më pak se 300 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje penale) për tre vjet. Duke zbatuar këtë rregull në rastin e subjektit të rivlerësimit {...} konstatohet se ngarkesa e tij sasimore ka qenë mbi standardin minimal sasior...”.*

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezultojnë se:**

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtari {...} ka përfunduar 811 çështje nga të cilat 558 penale themeli, 22 kërkesa me të dëmtuar akuzues dhe 231 kërkesa penale.

Referuar tabelave statistikore për periudhën 08.10.2013-08.10.2016 rezultojnë të dhënat e mëposhtme për kategori çështjesh për çdo vit kalendarik :

- (i) Viti 2013 (3 muaj): gjithsej 74 çështje nga të cilat 39 çështje penale (*krime dhe kundërvajtje penale*)- në standardin e miratuar duke llogaritur periudhën 3 mujore;

- (ii) Viti 2014: gjithsej 282 çështje nga të cilat 191 çështje penale (*krime dhe kundërvajtje penale*), ose 91% më shumë se standardi i miratuar;
- (iii) Viti 2015: gjithsej 285 çështje, nga të cilat 223 çështje penale (*krime dhe kundërvajtje penale*), ose 123% më shumë se standardi i miratuar;
- (iv) Viti 2016 (9 muaj): gjithsej 170 çështje nga të cilat 127 çështje penale (*krime dhe kundërvajtje penale*), ose 69% më shumë se standardi i miratuar, duke llogaritur periudhën 9 mujore.

Për aspektin sasior sipas pikës 3, germa “e” të vendimit të ish KLD-së, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë dhoma penale, si relator gjykon brenda një viti kalendarik jo më pak se 100 çështje që kanë të bëjnë me krime dhe kundërvajtje penale, i llogaritur në periudhë 3/vjeçare jo më pak se 300 çështje themeli.

Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelën e të dhënave statistikore, bashkëlidhur Formularit të vetëvlerësimit,<sup>34</sup> shënohen të dhënat statistikore të ndara sipas viteve kalendarike dhe konkretisht:

- Në vitin e plotë 2013, i janë caktuar si çështje të reja 313 çështje (*158 çështje penale themeli, 133 kërkesa penale dhe 22 kërkesa me të dëmtuar*), ka përfunduar 230 çështje (*102 çështje penal themeli, 108 kërkesa penale dhe 20 kërkesa me të dëmtuar*).
- Në vitin e plotë 2014, i janë caktuar si çështje të reja<sup>35</sup> 262 çështje (*182 çështje penale themeli, 73 kërkesa penale dhe 7 kërkesa me të dëmtuar*), ka përfunduar 282 çështje (*183 çështje penal themeli, 91 kërkesa penale dhe 8 kërkesa me të dëmtuar*);
- Në vitin e plotë 2015, i janë caktuar 280 çështje (*210 çështje penal themeli, 1 çështje penale ushtarake, 64 kërkesa penale dhe 5 kërkesa me të dëmtuar*), ka përfunduar 285 çështje (*218 çështje penal themeli, 62 kërkesa penale dhe 5 kërkesa me të dëmtuar*);
- Në vitin e plotë 2016, i janë caktuar 188 çështje (*126 çështje penal themeli, 57 kërkesa penale dhe 5 kërkesa me të dëmtuar*), ka përfunduar 224 çështje (*157 çështje penal themeli, 1 çështje penale ushtarake, 61 kërkesa penale dhe 5 kërkesa me të dëmtuar*).

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së 08.10.2013-08.20.2016, dhe po kështu nuk është përlllogaritur rendimenti sipas të dhënave statistikore nga raporti i vlerësimit të KLGJ-së, duke u bazuar në të dhënat statistikore bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit për periudhën e plotë 2013-2016, e cila në këtë rast konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi, rendimenti duhet të përcaktohet referuar raportit të çështjeve të përfunduara 1021 çështje, me çështjet e caktuara 1043 çështje gjatë periudhës së vlerësimit, **në masën 97,89%**.

<sup>34</sup> Në faqen 50 të dosjes së rivlerësimit

<sup>35</sup>“Çështje të reja” janë ato që janë regjistruar të reja brenda një viti kalendarik, duke hequr çështjet e mbartura nga vitet paraardhëse.



## KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 97,89%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”*. Në rastin konkret, rezulton se gjyqtari {...}, ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% e standardit minimal të ngarkesës, kështu:

- për vitin 2013 ka gjykuar 22% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (122 çështje të gjykuara, nga 100 çështje (krime dhe kundërvajtje) të përcaktuar në standardin sasior të punës);
- për vitin 2014 ka gjykuar 91% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (191 çështje të gjykuara, nga 100 çështje (krime dhe kundërvajtje) të përcaktuar në standardin sasior të punës);
- për vitin 2015 ka gjykuar 123% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (223 çështje të gjykuara, nga 100 çështje (krime dhe kundërvajtje) të përcaktuar në standardin sasior të punës);
- për vitin 2016 ka gjykuar 63% më shumë se standardi sasior i punës së gjyqtarit të shkallës së parë i dhomës penale (163 çështje të gjykuara, nga 100 çështje (krime dhe kundërvajtje) të përcaktuar në standardin sasior të punës).

Pra, në gjithë periudhën e vlerësimit gjyqtari ka gjykuar në total 699 çështje (krime dhe kundërvajtje), ose rreth 75% më shumë se standardi sasior i punës. Në këto kushte gjyqtari për këtë tregues pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi nga ajo që rezulton nga analiza matematikore, pasi nga kjo e fundit, duket që rendimenti si tregues i aftësive organizative të gjyqtarit, është kushtëzuar në këtë rast nga fluksi i madh i prurjeve të çështjeve të reja, çka nuk është përgjegjësi e gjyqtarit dhe jo nga mungesa e produktivitetit të gjyqtarit në menaxhimin e kohës, planifikimin e organizimin e procesit gjyqësor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin *“Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”* gjyqtari pikëzohet me 10 pikë.

## 2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë

periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...}, vetëm në dy raste i ka kushtuar rëndësi arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke i arsyetuar shpejt ato dhe brenda afateve ligjore dhe në tre raste vendimet janë arsyetuar jashtë afatit ligjor. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 15 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), duke vënë në vështirësi të pandehurën për të paraqitur ankim (në dosje është apelimi paraprak për zënie afati paraqitur nga e pandehura A. Arifaj më datë 08.01.2014), për 5 ditë nga shpallja (shih dosjen 2), për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 3), për 6 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe për 12 ditë nga shpallja (shih dosjen 5)”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

- (i) Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 1822, datë 26.12.2013, është dorëzuar në datën 10.01.2014 - (15 ditë), jashtë afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (ii) Dosja 2, që i përket vendimit me nr.1678, datë 12.12.2013, është dorëzuar në datën 17.12.2013 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (iii) Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 2738, datë 13.11.2014, është dorëzuar në datën 17.11.2014 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (iv) Dosja 4, që i përket vendimit me nr.3275, datë 23.12.2014, është dorëzuar në datën 29.12.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (v) Dosja 5, që i përket vendimit me nr.53, datë 23.03.2016 është dorëzuar në datën 05.04.2016 - (13 ditë), jashtë afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr.1108/1 prot, datë 27.04.2023, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 11.04.2023, rezulton se:

- (vi) Dosja 6, që i përket vendimit me nr.2388, datë 17.10.2014 është dorëzuar në datën 21.10.2014 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (vii) Dosja 7, që i përket vendimit me nr.783, datë 11.04.2014 është dorëzuar në datën 23.04.2014- (12 ditë), jashtë afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (viii) Dosja 8, që i përket vendimit me nr.2213, datë 19.06.2015 është dorëzuar në datën 24.06.2015- (5 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (ix) Dosja 9, që i përket vendimit me nr. 2534, datë 07.07.2015 është dorëzuar në datën 21.07.2015- (14 ditë), jashtë afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (x) Dosja 10, që i përket vendimit me nr.2646, datë 13.09.2016 është dorëzuar në datën 20.09.2016- (7 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (xi) Dosja 11, që i përket vendimit me nr.71, datë 19.01.2016 është dorëzuar në datën 28.01.2016- (9 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë penale krime, për 10 dosje është 8.1 ditë dhe për kategorinë penale - kundërvajtje, për 1 dosje është 13 ditë.

Nga të dhënat e analizuarra më sipër, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar, nga 2 (dy) kategori çështjes, për 1 (një) prej tyre rezulton e tejkalar me vetëm 3 (tre) ditë, në raport me afatin 10 ditor të ankimit, analizuar më sipër në këtë tregues.

## **KONKLuzioni**

Sa më sipër analizuar si në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, ashtu edhe nga të dhënat e sipërcituara në lidhje me dosjet e shortuara, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve, rezulton e tejkalar me vetëm 3 ditë, tejkalarim i papërfillshëm që nuk afekton shkallën e aftësisë së gjyqtarit në drejtim të arsyetimit në kohë të vendimeve.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE**

### **2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE GJYQËSORE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} përgjithësisht merr masat për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, me qëllim përfundimin në kohë të tyre. Në një rast të gjykuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar ka pasur mangësi në marrjen e këtyre masave (shih dosja nr. 1). Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore, me përjashtim të dosjes nr. 5 ku afati është në tejkalarim të parashikimit ligjor në nenin 333 të K.Pr.Penale. Në 5 çështje penale të vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 47 seanca (shih dosjen 1), me 2 seanca (shih*

*dosjen 2), me 5 seanca (shih dosjen 3), me 6 seancë (shih dosjen 4) dhe me 1 seancë (shih dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 61 seanca gjyqësore, nga të cilat 17 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 44 seanca joproduktive kanë qenë mungesa e të pandehurit dhe mbrojtësit (14 seanca), mungesa e dëshmitarëve (10 seanca), mungesa e ekspertëve (2 seanca), mungesa e prokurorit (13 seanca) dhe mungesa e gjyqtarit (5 seanca), ku shkak ka qenë pjesëmarrja në mbledhje, seminare, provimin e gjykatës administrative dhe për shkak të një gjykimi tjetër... Distanca kohore midis seancave përgjithësisht respektojnë afatet ligjore, por ka raste kur shtyrja është në një afat kohor nga 15-33 ditë, në shkelje të afatit të parashikuar në nenin 342/2 të K.Pr.Penale (shih dosja 1, 3 dhe 4). Në disa raste shtyrjet e seancave nuk janë të arsyeshme në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë, kryesisht në rastin e gjykimit të zakonshëm, ku është shtyrë seanca për shpalljen e vendimit pa u arsyetuar shkaku i shtyrjes, si rast i pamundësisë absolute të menjëhershmerisë së marrjes së vendimit sipas nenit 379 të K.Pr.Penale (shih dosja nr. 1). Përgjithësisht rezulton se në një rast nuk janë monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur shtyrjen e seancës. Në dosjen gjyqësore nuk ka akte njoftimi për palët, dëshmitarët dhe ekspertët (shih dosja nr. 1)”.*

**- Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :**

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit:

Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

➤ Dosja 1 – që i përket çështjes penale me nr.25 regjistri, datë regjistrimi 26.10.2011, gjykimi i të pandehurve për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.1822, datë 26.12.2013, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 47 (dyzet e shtatë) seanca gjyqësore, nga të cilat 31 seanca kanë rezultuar joproduktive (4 seanca për mosformim të trupit gjykues, 13 seanca për mosparaqitjen e prokurorit, 10 seanca për mosparaqitje të të pandehurit apo mbrojtësit të zgjedhur, 4 seanca për mosparaqitjen e dëshmitarëve apo ekspertit). Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimin e dëshmitareve, shqyrtimin e kërkesës për përjashtim gjyqtari, njoftimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht, lënien kohë prokurorit për të paraqitur provat shkresore, lënien kohe mbrojtëse për tu njohur me provat, njoftimin e ekspertit, lënien kohë mbrojtësit për të paraqitur provat, lënien kohë prokurorit për të përgatitur pretendimet përfundimtare, lënien kohë mbrojtësve për të përgatitur pretendimet përfundimtare dhe shpalljen e vendimit të arsyetuar.

Lidhur me këtë çështje, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe në kundërshtim të pretendimeve të Komisionerit Publik gjatë gjykimit në Kolegj, gjyqtari ka parashtruar se: ...Vetëm 4 nga 38 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkaqe të pavarura nga

*puna si gjyqtar, nga të cilat: seanca e datës 13.12.2011 është shtyrë, për shkak se, duke qenë pjesë e grupit të punës për ngritjen dhe funksionimin e Shërbimit të Provës ... jam përzgjedhur për të trajnuar punonjësit e drejtësisë dhe të agjencive të zbatimit të ligjit, lidhur me dënimet alternative... Si moderatore e këtij takimi ishte përcaktuar znj. A.B., gjyqtare në Gjykatën e Krimeve të Rënda, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Lartë. Për shkak të angazhimeve të saj të papritura, gjyqtarja më ka kërkuar, nëpërmjet e-mail-it të saj, që ta zëvendësoj, me qëllim evitimin e dështimit të këtij seminari trajnues mjaft të rëndësishëm; seanca e datës 20.02.2012, është shtyrë për shkak se gjykimi i çështjes pararendëse me të pandehur A. J. dhe të tjerë, ka zgjatur disa orë, tej kohës së parashikuar nga unë prej 1 ore, për shkak të pyetjes së dëshmitarëve ...; seanca e datës 30.04.2012, është shtyrë për shkak se kam qenë i angazhuar në projektet e ndryshme, lidhur me reformimin e sistemit të drejtësisë në vend, kryesisht atij penitenciar dhe shërbimit të provës, pasi takimet për këtë qëllim zhvilloheshin ndonjëherë në mënyrë të paparashikuar; seanca e datës 30.04.2013 është shtyrë, pasi ish-KLD-ja kishte shpallur datën e konkursit për t'u emëruar si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Administrativ, e cila u krijua për herë të parë me ligjin nr. 49/2012 ...”.*

Lidhur me administrimin e procesit gjyqësor nga e gjyqtarit relator {...}, Kolegji ka vlerësuar se shtyrjet e seancave gjyqësore për shkak të angazhimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit, kanë qenë të justifikuara, por megjithatë ato mund të shmangeshin me një kujdes të shtuar të subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues çmon të theksojë se konkluzioni i mësipërm nuk mund të sjellë ndikim në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, pasi numri i seancave të shtyra për shkak të angazhimeve të tjera të tij është shumë i vogël krahasuar me numrin total të seancave gjyqësore joproductive në çështjen objekt kontrolli, por edhe nga pesë dosjet/çështjet gjyqësore të shortuara, vetëm për këtë çështje është konstatuar nga KLGJ-ja se kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar afatin 9-mujor të përcaktuar në Aneksin 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Ndryshimet në konkluzionet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe konstatimeve të raportit analitik duket që kanë ardhur për shkak të mos administrimit të plotë të dosjes nr.1 në kuadër të përgatitjes së raportit analitik si raport ndihmës për analizimin e aftësive profesionale të gjyqtarit në procesin e rivlerësimit kalimtar. Ndryshe nga sa konstatohet në raportin analitik, nga këqyrja e plotë e akteve të dosjes nr.1 administruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe përmbajtja e tyre, konstatohet se veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari që kanë të bëjnë me njoftimet e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve janë dokumentuar dhe janë të pasqyruara në fashikullin përkatës, gjithsej 59 fletëthirrje dhe njoftime për të pandehurat, avokatët, dëshmitarët, ekspertët dhe prokurorin. Gjithashtu, rezulton se ka pasur komunikim të gjyqtarit me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, për zbatimin e rreth 15 urdhrave të gjyqtarit për njoftimin e të pandehurave, dëshmitarëve apo ekspertëve, për njoftimin e të cilëve megjithëse është lëshuar fletëthirrje, nuk janë paraqitur në gjykim.

Në rastet e mungesave të paarsyeshme të të pandehurave apo mbrojtësve të tyre, rezultojnë se gjyqtari ka proceduar me vijimin e gjykimit në mungesë apo me caktimin e mbrojtësve kryesisht. Këto veprime evidentohen në seancat gjyqësore të datës 12.12.2012 dhe datës 28.06.2013, ku për shkak të mungesës së paarsyeshme të së pandehurës A. A. dhe avokatit të saj, është caktuar, kryesisht, avokate N. P., si dhe në seancën e datës 10.09.2013, në të cilën për shkak të mungesës së paarsyeshme të së pandehurës A. A. dhe avokatit të saj është caktuar kryesisht avokate M. R.

Nga situata faktike e mësipërme e gjendjes së akteve në dosjen nr.1, duke i ballafaquar ato dhe me përmbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore, evidentohet lehtësisht se konstatimi i raportit analitik të vlerësimit lidhur me aktet e njoftimit, ka ardhur si pasojë e mungesës së këtyre akteve në dosjen e verifikuar, pasi ajo nuk është administruar e plotë fillimisht. Gjendja e plotë e akteve të njoftimit në dosjen e plotë të përcjellë nga gjyqtari në Komision, provon faktin se gjyqtari ka ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale në drejtim të njoftimit të palëve, për organizimin e procesit gjyqësor.

➤ Dosja 2—që i përket çështjes penale me nr.2021 regjistri, datë regjistrimi 29.10.2013, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.1678, datë 12.12.2013, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka patur seanca joproductive.

➤ Dosja 3—që i përket çështjes penale me nr.2730 regjistri, datë regjistrimi 25.07.2014, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.2738, datë 13.11.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat 3 (tre) seanca kanë rezultuar joproductive, për shkak të mosformimit të turpit gjykues, mosrealizimit të njoftimit nga policia gjyqësore për të pandehurin dhe mosparaqitjes së prokurorit.

➤ Dosja 4—që i përket çështjes penale me nr.2933 regjistri, datë regjistrimi 11.09.2014, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.3275, datë 23.12.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 6 (gjashtë) seanca gjyqësore, nga të cilat 3 (tre) seanca kanë rezultuar joproductive, për shkak të mosparaqitjes së prokurorit. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale si njoftimi i mbrojtësit të zgjedhur nga i pandehuri, lënien kohë palëve për të përgatitur diskutimet përfundimtare.

➤ Dosja 5—që i përket kërkesës penale me nr.53 regjistri, datë regjistrimi 17.02.2016, gjykimi i të akuzuarit për veprat penale “Dëmtime me dashje i pronës” dhe “Fshehje e pronës”, përfunduar me vendimin nr.53 akti, datë 23.03.2016, e Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar vetëm 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.

Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

➤ Dosja 6–që i përket çështjes penale me nr.2273 regjistri, datë regjistrimi 10.06.2014, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.2388, datë 17.10.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 6 (gjashtë) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 (dy) seanca kanë rezultuar joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimin e mbrojtësit të zgjedhur nga i pandehuri, lënien kohë mbrojtësit për tu njohur me aktet, për t’i lënë mbrojtësit për përgatitjen e diskutimeve përfundimtare me shkrim.

➤ Dosja 7–që i përket çështjes penale me nr.930 regjistri, datë regjistrimi 17.01.2014, gjykimi i të pandehurve për veprat penale “Vjedhja” dhe “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga nenet 134/1 dhe 300 të K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.783, datë 11.04.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore nga të cilat 2 (dy) seanca kanë rezultuar joproduktive, për shkak të mosrealizimit të njoftimit të të pandehurve nga ana e policisë gjyqësore. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si lënien kohë palëve për të përgatitur pretendimet përfundimtare.

➤ Dosja 8–që i përket çështjes penale me nr.2889 regjistri, datë regjistrimi 15.05.2015, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr. 2213, datë 19.06.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar vetëm 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.

➤ Dosja 9–që i përket çështjes penale me nr. 2278 regjistri, datë regjistrimi 03.04.2015, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr. 2534, datë 27.07.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 6 (gjashtë) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 (dy) seanca kanë rezultuar joproduktive, për shkak të mosrealizimit të njoftimit të të pandehurit nga ana e policisë gjyqësore. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: lënien kohë palëve për përgatitjen e diskutimeve përfundimtare me shkrim.



➤ Dosja 10–që i përket çështjes penale, me nr. 3125 regjistri, datë regjistrimi 24.06.2016, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Vjedhje me armë”, parashikuar nga neni 140 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr. 2646, datë 13.09.2016, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca, të cilat kanë rezultuar produktive.

➤ Dosja 11–që i përket çështjes penale, me nr. 5119 regjistri, datë regjistrimi 13.11.2015, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr. 71, datë 19.01.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca, të cilat kanë rezultuar produktive

Nga tërësia e të dhënave siç parashtrohen më sipër, nëse do të përjashtonim dosjen nr.1 ku numri i seancave është 47 seanca dhe riti i gjykimit ka qenë gjykim i zakonshëm, çështje e cila ka zgjatur në kohë për shkaqet procedurale të analizuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të tilla që nuk varen nga gjyqtari, analizuar më sipër në raport, rezulton se për 10 dosjet e tjera gjyqësore të analizuar (*penale themeli me palë kundërshtare*), numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari, varion nga 1 deri në 6 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar këtyre 10/ çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 3.5 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje penale themeli) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në përgjithësi ligjin procedural (neni 333 dhe 342/2 të K.Pr.Penale), përveçse kur distanca nga njëra seancë tek tjetra ka qenë më e largët se 15 ditë për shkak të pushimeve vjetore në muajin gusht, për shkak të fund vitit e cila përkon me periudhën ku sekretaria gjyqësore kryen veprimin administrativ të mbartjes së dosjeve, apo për shkak të pritjes së shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit nga shqyrtimi i çështjes.

Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Lidhur me konstatimin e bërë në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, se gjyqtari nuk ka mbikëqyrur rregullisht aktet e njoftimit, duke sjellë shtyrjen e seancave dhe në dosje nuk ka akte njoftimi për palët, Kolegji pasi ka analizuar aktet në dosjen e çështjes nr. 25, datë 26.10.2011 regjistrimi, duke i ballafaquar ato dhe me përmbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore, ka vlerësuar se gjendja e akteve të njoftimit në dosjen e plotë të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit në

Komision, provon faktin se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale në drejtim të njoftimit të palëve, për organizimin e procesit gjyqësor.

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues, rezulton që për seancën vijuese janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimit i të pandehurve nëpërmjet policisë gjyqësore, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurve, njoftimi për të marrë pjesë i prokurorit, njoftimi i ekspertit, njoftimi i mbrojtësit të caktuar kryesisht, për të përgatitur pretendimet përfundimtare me shkrim, etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, përveçse kur kjo ka qenë objektivi i pamundur.

Pavarësisht numrit mesatar të seancave, gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Shkaqet e shtyrjeve lidhen me kryerjen e veprimeve procedurale të domosdoshme, si njoftimi i të pandehurit, mbrojtësve, dëshmitarëve, apo që lidhen me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit etj.

#### **KONKLuzioni**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3 (në fakt ky numër tejkalohet vetëm me 0,5 % nëse përjashtojmë dosjen nr.1), shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuara, nuk vjen për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit. Gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në shmangien e seancave joproductive.*

#### **2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Subjekti i rivlerësimit {...} përgjithësisht merr masat për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, me qëllim përfundimin në kohë të tyre. Në një rast të gjykuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar ka pasur mangësi në marrjen e këtyre masave (shih dosja nr. 1). Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore, me përjashtim të dosjes nr. 5 ku afati është në tejkalim të parashikimit ligjor në nenin 333 të K.Pr.Penale....Seancat gjyqësore janë çelur përgjithësisht në orarin e planifikuar (me vonesë të papërfillshme gjer në 5 minuta, që tregon edhe përpikmërinë e dokumentimit të tyre), me përjashtim të 8 seancave, të cilat kanë filluar me vonesë 14-30 minuta (shih dosjet 1, 2 dhe 4). Në 6 prej këtyre rasteve subjekti i rivlerësimit ka relatuar shkakun e vonesës, që lidhej me pjesëmarrjen e tij në gjykime të tjera apo me paraqitjen e vonuar të palëve, kryesisht prokurorit (shih dosjet 1, 2 dhe 4), ndërsa në 2 raste shkakun e vonesës nuk është relatuar (shih dosjen 1 dhe 4). Gjyqtari {...} jo në çdo rast e ka respektuar solemnitetin, duke zhvilluar gjykimin në sallë dhe duke i regjistruar audio seancat gjyqësore. Nga 5 dosjet e vëzhguara rezulton se vetëm në 2 raste gjykimi është zhvilluar në sallë, duke i regjistruar audio seancat gjyqësore, por CD-të e këtyre seancave nuk janë administruar dhe nuk janë paraqitur bashkë me dosjet përkatëse, por janë kërkuar nga ana jonë dhe janë paraqitur me shkresën nr. 1841 prot., datë 18.06.2019. Gjyqtari {...}, zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin gjyqësor, kërkimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar (shih dosja nr. 5). Ai identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerrë urdhra dhe vendime të ndërmjetme por jo në çdo rast të arsyetuara (shih dosja 1)....”*

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :**

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, të gjitha çështjet i përkasin kategorisë së çështjeve penale me palë kundërshtare.

Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës së parë gjyqësore, në çdo rast 2 deri 9 ditë pas caktimit të çështjes me short, duke respektuar afatin procedural 10 ditor, të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale. Seancat gjyqësore për 11 dosjet që i përkasin çështjeve të themelit, në përgjithësi janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor, të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale. Thuhet në përgjithësi, pasi në disa raste seancat gjyqësore janë planifikuar dhe

zhvilluar jashtë afatit procedural 15 ditor, të parashikuar në nenin 342 të K.Pr.Penale, konkretisht: pas 37, 20, 74, 28 dhe 48 ditësh;<sup>36</sup> pas 47 ditësh.<sup>37</sup>

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara përgjithësisht janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur me shtypshkrim nga sekretarja gjyqësore, vetëm në disa raste seancat janë mbajtur edhe me sistemin e regjistrimit audio.

Lidhur me mosdokumentimin e seancave me regjistrim audio, nga ana e KPA-së është konkluduar se: *“...Në mbështetje të parashikimit ligjor të sipërcituar, i lexuar në harmoni edhe me përcaktimet e aktit nënligjor të ministrit të Drejtësisë dhe urdhrin nr. 5895 prot., datë 15.05.2013, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, trupi gjykues çmon se është i bazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se regjistrimi audio i seancave gjyqësore nuk ka qenë i detyrueshëm. Nga verifikimi i datave të procesverbaleve të seancave gjyqësore të çështjes objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi se seanca e parë gjyqësore është zhvilluar më datë 26.10.2011, ndërsa e fundit është zhvilluar më datë 26.12.2013. Në periudhën 7-mujore, nga data 15.05.2013, si datë e nxjerrjes së urdhrin të kryetarit të gjykatës për fillimin e funksionimit të sistemit audio, janë zhvilluar vetëm 14 seanca gjyqësore pa përdorimin e regjistrimit audio, siç rezulton nga procesverbalet gjyqësore. Në analizë të panoramës faktike dhe parashikimeve ligjore të pasqyruara më sipër, trupi gjykues çmoi të mbante në konsideratë se zhvillimi i gjykimeve në salla, bëhej sipas një kalendari të caktuar dhe në varësi të disponibilitetit të sallave, ashtu siç urdhërohej në aktin nënligjor të nxjerrë nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pasojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se mospërdorimi i regjistrimit audio në seancat gjyqësore të çështjes objekt kontrolli, ka ndodhur për shkaqe objektive, është i bazuar. Në përfundim të shqyrtimit e analizës së këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, për pasojë nuk evidentohen veprime në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 96/2016, të tilla që të afektojnë vlerësimin e aftësive profesionale të kryer nga Komisioni, apo që çojnë në konkluzionin se, në vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016”*.

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal, sipas parashikimeve të nenit 335 e vijues të K.Pr.Penale dhe 405 e vijues, në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar. Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve,

<sup>36</sup>Seancat e datave 13.12.2011, 19.01.2012, 22.06.2012, 21.12.2012, 24.07.2013, në dosjen nr.1, ku evidentohet se në tejkalimin e afatit ligjor 15 ditë ka ndikuar periudha e fund vitit, e cila përkon me mbajtjet e çështjeve, si dhe pritja për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtari dhe periudha e pushimeve vjetore në muajin gusht

<sup>37</sup>Seanca e datës 18.07.2014, në dosjen me nr.6 është shtyrë tej këtij afati për shkak të pushimeve në muajin gusht.

marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, marrjen e vendimeve për zhvillimin e gjykimit në mungesë, sipas parashikimeve të neneve 351 dhe 352 të K.Pr.Penale, sipas rastit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa 2 deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë konstatohen edhe disa seanca (6 seanca)<sup>38</sup> të filluara me më shumë se 18 minuta deri në 40 minuta vonesë nga ora e planifikuar. Në tërësi, pavarësisht fillimit me vonesë të disa prej seancave gjyqësore, të cilat rezultojnë në një përqindje të vogël në raport me seancat e analizuar (*7.3% e seancave rezultojnë të filluara me vonesë*) nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes, përveç në një rast në të cilën seanca gjyqësore nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtari ka qenë duke zhvilluar një proces tjetër gjyqësor, të zgjatur tej orarit të planifikuar.<sup>39</sup> Shkaku i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relatimit të gjyqtarit lidhet me pjesëmarrjen e tij në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, apo edhe në pritje të paraqitjes së prokurorit.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

---

<sup>38</sup>Dosja 1 – Seancat gjyqësore të datave 08.02.2012, 02.11.2012 dhe 08.04.2013, janë çelur respektivisht me 40, 30 dhe 30 minuta vonesë, për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar; Dosja nr.2- Seanca e datës 12.12.2013 është çelur me 21 minuta vonesë; Dosja nr.4, seanca e datës 23.12.2014 është cefluar me 21 minuta vonesë, për shkak të pritjes së prokurorit dhe trupi gjykues ndodhej në një gjykim tjetër; Dosja nr.10 seanca e datës 13.09.2016 është çelur 18 minuta me vonesë.

<sup>39</sup>Në dosjen me nr.1822 vendimi, datë 26.12.2013, seanca e datës 20.02.2012, nuk është zhvilluar për shkak se gjyqtari ndodhej në një tjetër gjykim penal, të zgjatur tej orarit të planifikuar

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

## **2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE**

### **2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të përgjithësisht të rregullta. Në 3 dosje penale të themelit ndodhet fashikulli i prokurorit, vendimi i subjektit të rivlerësimit për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit, aktet e hetimit paraprak të bashkuara me fashikullin e gjykimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, procesverbali gjyqësor, konkluzionet përfundimtare të prokurorit dhe vendimi gjyqësor (shih dosjet 2, 3 dhe 4). Në një rast ku gjykimi ka vazhduar me procedurën e gjykimit të zakonshëm nuk ndodhet fashikulli i prokurorit dhe sistemimi i akteve nuk e lehtëson përdorimin e saj (shih dosja 1). Procesverbali i seancës gjyqësore në të gjitha rastet është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera dhe i nënshkruar rregullisht prej sekretares gjyqësore dhe gjyqtarit, konform kërkesave të neneve 345 dhe 346 të K.Pr.Penale. Vetëm në 1 rast është konstatuar pasqyrimi jo i plotë i vitit në mbyllje të procesverbalit të seancës së parë gjyqësore, por nuk ka sjellë pasoja (shih dosjen 2). Në çdo dosje është përfshirë 1 kopje e vendimit e hartuar me kompjuter dhe e nënshkruar vetëm nga gjyqtari/gjyqtarët, si dhe një kopje e vendimit e nënshkruar nga gjyqtari/gjyqtarët dhe sekretarja gjyqësore. Aktet 4 nga 5 dosjet e vëzhguara janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale penale, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët dhe në fund është fashikulli i prokurorit. Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht. Në një rast sistemimi i akteve nuk e lehtëson përdorimin e saj (shih dosja 1). Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes fillon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet dhe shkresat e kryera gjatë gjykimit në rend kronologjik, provat shkresore të dorëzuara në seancë për shkak të paraqitjes së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Lidhur me konstatimin e bërë në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, se në një rast sistemi i akteve nuk lehtëson përdorimin e saj (Dosja nr.1), gjatë hetimit administrativ në Kolegji e Posaçëm të Apelit u evidentua se “.....dosja e çështjes penale nr.25, datë 26.10.2011, nuk është administruar e plotë nga KLGJ-ja dhe e tillë është përcjell në komision”.<sup>40</sup> Pra, konkluzioni si më sipër në raportin për analizimin e aftësive profesionale ka ardhur si pasojë e mos administrimit të plotë të dosjes gjyqësore.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.*

## **2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

---

<sup>40</sup> Faqja 62 e vendimi nr.27, datë 06.07.2022 e KPA

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Aktet 4 nga 5 dosjet e vëzhguara janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale penale, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët dhe në fund është fashikulli i prokurorit. Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht. Në një rast sistemimi i akteve nuk e lehtëson përdorimin e saj (shih dosja 1). Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

## **KONKLUZIONE**

DUKE IU REFERUAR BURIMEVE TË VLERËSIMIT, REZULTON SE GJYQTARI KA SHKALLË AFTËSIE SHUMË TË LARTË NË KËTË TREGUES.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100



### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### 3.A. ETIKA NË PUNË

##### 3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Gjyqtari {...} ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 15.07.2000 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2003. Pas studimeve, në datën 21.10.2003, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë që kryen dhe aktualisht. Ai është zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 14.12.2015 deri më 12.12.2018. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit {...} (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së). Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.”

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:**

Nga regjistri i ankesave, rezulton se për gjyqtarin {...}, gjatë periudhës së rivlerësimit paraqitur 7 (shtatë) ankesa, për të cilat referohet se: “... Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “08 tetor 2013- 08 tetor 2016”, për gjyqtarin {...} janë paraqitur 7 ankesa (5 në vitin 2014, 1 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. 5 ankesa (3 të vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar ndër të cilat 4 me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, dhe 1 ankesë me arsyetimin se është ankesë e përsëritur. 2 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë: 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar për shkelje etike është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara. 1 ankesë e

*vitit 2014 verifikuar për zvarritje dhe mosrespektim formal ligji është arkivuar, pasi pretendimet janë të pabazuara”.*

Nga aktet e dosjes së rivlerësimit, rezulton se në të nuk janë administruar aktet lidhur me verifikimin e ankesave. Për këtë arsye, u administruan nga arkiva e KLGJ, aktet përkatëse për verifikimin e secilës ankesë. Nga administrimi i tyre rezulton se pas trajtimit të tyre, të gjitha ankesat janë arkivuar.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD dhe në vendimin nr.3181/2 prot., datë 29.03.2022 të ILD, trajtuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij raporti, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 27, datë 06.07.2020 i cili ka lënë në fuqi vendimin Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, rezulton se janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pabazuara.

Për periudhën e vlerësimit tetor 2013-tetor 2016 nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cenimit të etikës së gjyqtarit.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” shkalla e aftësisë vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar gjyqtari me 35 pikë.

### **3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT**

Lidhur me këtë nënkriter, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”*.

#### **3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin 7 ankesa, në Inspektoratin e KLD-së, të cilat janë trajtuar, dhe arkivuar, sipas argumenteve të analizuara më sipër në këtë raport. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së me nr. 393, datë 03.06.2021 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 27, datë 06.07.2022 në lidhje me etikën, kriterin e vlerësimit të figurës dhe pasurisë, ka konkluduar si vijon: *“...Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara apo mungesa financiare si më sipër nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe as besimin e publikut te drejtësia. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka*

*arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.... Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. {...}, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016”.*

Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në vendimi nr. 27, datë 06.07.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, konkluzohet se: *“82. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit për to, në mbështetje të konkluzioneve të arritura, trupi gjykues, në bazë të autoritetit diskrecional për zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit e kalon testin e standardit kushtetues të provimit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe gjithashtu gjendet edhe në kushtet e parashikuara edhe nga neni 59, pika 1, 50 shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 , duke arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë... 98. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit dhe nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, për pasojë ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerësoi se vendimi i Komisionit nr. 393, datë 03.06.2021, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...}, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi”.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” shkalla e aftësisë së gjyqtarit vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

### **3.C PAANËSIA E GJYQTARIT**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve (me përjashtim të një rasti kur prokurori është shprehur në seancë gjyqësore se kërkon përjashtimin e gjyqtarit dhe është ndërprerë*

*seanca për t'u shprehur një tjetër trup gjykues, por nuk ka të dhëna nga aktet e dosjes nëse është paraqitur kjo kërkesë nga prokurori dhe është disponuar nga gjykata me vendim. Rezulton se prokurori i çështjes me vendim të Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është zëvendësuar me tjetër prokuror – shih dosjen 1). Në 5 dosjet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e standardit të gjykatës së paanshme”.*

### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me palët në proces ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

### **3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se:*

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (*11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari*) rezulton se për gjyqtarin {...} është paraqitur një kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes. Konkretisht, referuar akteve të dosjes me nr.1822 vendimi, datë 26.12.2013, rezulton se gjatë gjykimit të çështjes penale, në seancën e datës 22.06.2012 është kërkuar nga prokurori përjashtimi i gjyqtarit {...}. Seancë e cila është ndërprerë për shqyrtimin e kësaj kërkesë nga një tjetër trup gjykues. Në dosje nuk ka të dhëna lidhur me vendimin për kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, por në kushtet kur gjykimi ka vijuar me të njëjtin trup gjykues, presumohet se kjo kërkesë nuk është pranuar.

Nga ana tjetër, nga tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, rezulton se nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet i pakonsiderueshëm.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet *si i pakonsiderueshëm*.

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “I pa konsiderueshëm”.*

#### **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### **4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT**

##### **4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari {...} komunikon me etikë me palët në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:**

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, etj.*) është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### **4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:**

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.



## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “..Në 3 dokumentet ligjore dhe në 4 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në 4 çështje gjyqësore të vëzhguara, ai ka qenë gjyqtar i vetëm për gjykimin e çështjes dhe në 3 prej tyre është konstatuar se ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale penale, duke respektuar afatet dhe duke dokumentuar rregullisht veprimet (shih dosjet 2, 3 dhe 5). Në një rast nuk janë dokumentuar rregullisht veprimet kryesisht ato që kanë të bëjnë me njoftimet, duke mos u respektuar afati për gjykimin e çështjes (shih dosja 1). Në një çështje tjetër, ai ka gjykuar në trup gjykues, me tre gjyqtarë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues dhe bashkëpunimi e shkëmbimi i njohurive apo përvojave profesionale me ta përgjithësisht ka qenë në nivelin e duhur: vetëm një seancë ka dështuar për mungesë të dy anëtarëve të trupit gjykues, por nuk është pasqyruar shkak i mungesës dhe nëse ky shkak ka lidhje me mungesën e bashkëpunimit të subjektit të rivlerësimit me ta. Në seancat e tjera nuk ka pasur problematikë në këshillimin e marrjes së vendimeve të ndërmjetme apo përfundimtar, si dhe nuk ka pasur problematika të shkeljes së afateve (shih dosjen 4). Në 5 dosjet e vëzhguara në përgjithësi nuk është identifikuar vonesë e pajustificuar dhe e padokumentuar në fillimin e seancave gjyqësore, por ka vonesa në depozitim të dosjes me vendimin e arsyetuar në sekretari, që nuk rezulton se është një tregues i bashkëpunimit të duhur të subjektit të rivlerësimit, por i vonesës në arsyetimin e vendimit”.

#### **4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:*

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Konstatimet e mësipërme në raportin e analizimit të aftësive profesionale, nuk tregojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mungesën e bashkëpunimit me kolegët, pasi fillimet me disa minuta vonesë të seancave gjyqësore, kanë ardhur për shkak të zgjatjes së proceseve të mëparshme për arsye objektive. Përkundrazi, kjo sjellje e gjyqtarit tregon korrektesën e tij dhe bashkëpunimin me kolegët, duke i dhënë të njëjtën rëndësi të gjitha proceseve gjyqësore, si kur është kryesues i trupit gjykues ashtu edhe kur është anëtar. Nuk ka procese të shtyra për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarëve në procese të tjera. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga te burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social ...etj, duhet të vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Dorëzimi me vonesë nga sekretarja gjyqësore në sekretari e dosjes gjyqësore, me vendimin përfundimtar të arsyetuar brenda afatit, e identifikuar si gjetje në raportin e përgatitur në kuadër të procesit të rivlerësimit, kapërcen mundësinë objektive të gjyqtarit për mbikëqyrjen e veprimeve të sekretares gjyqësore dhe si i tillë vetëm ky rast i veçuar nga 811 çështje të përfunduara me vendim përfundimtar, nuk përbën të dhënë të tërthortë që ndikon në matjen e këtij treguesi në rastin konkret.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar vlerësimit të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me

administratën gjyqësore, gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “... Pas studimeve, në datën 21.10.2003, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë që kryen dhe aktualisht. Z. {...} është zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore, si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 14.12.2015 deri më 12.12.2018. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjithashtu se ka qenë ekspert, pedagog i jashtëm oponent në Shkollën e Magjistraturës, ekspert ligjor pranë Prezencës së OSBE-së, pedagog i jashtëm në Fakultetin Jopublik “Luarasi”, anëtar i panelit për çështje të disiplinës pranë Ligës Europiane të Notit dhe Kryetar i Komisionit të Apelimit në Federatën Shqiptare të Notit dhe lehtësues në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në 9 aktivitete trajnuese gjatë periudhës së rivlerësimit. Z. {...} është Kryetar i Shoqatës “Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë” që nga viti 2008 e aktualisht. Gjithashtu, ai ka qenë pjesëmarrës si ekspert në 6 trajnime në programin e formimit vazhdues të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës për vitet 2014-2016 dhe si pjesëmarrës në 4 trajnime, si dhe ka marrë pjesë në aktivitete të organizuara jashtë Shkollës së Magjistraturës në 8 trajnime. Të dhënat e analizuar tregojnë se ai ka marrë pjesë 33 ditë në trajnime të formimit vazhdues për periudhën e rivlerësimit, si pjesëmarrës, ekspert dhe në trajnime jashtë Shkollës së Magjistraturës (në tre trajnime jashtë Shkollës së Magjistraturës nuk janë përcaktuar periudhat kohore në ditë) . Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka qenë e ndryshme, duke i shërbyer detyrës së tij të gjyqtarit në dhomën penale të shkallës së parë, si dhe funksioneve të kryetarit të shoqatës. Nga ana tjetër, gjyqtari {...} ka deklaruar se është i pajisur me dëshminë e gjuhës angleze. Gjyqtari {...} është angazhuar gjithashtu, edhe në veprimtari akademike në institucionet e arsimit të lartë”.

#### **4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit me nr. 430/1 prot., datë 25.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit dhe të pjesëmarrësit.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.430/1 Prot., datë 25.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e ekspertit në 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese, gjithsej 12 ditë trajnimi dhe në cilësinë e pjesëmarrësit në 4 (katër) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 7 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9<sup>41</sup> të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 31 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

Rezulton gjithashtu se gjyqtari ka marrë pjesë në 4 (katër) aktivitete profesionale, gjithsej 18 ditë, jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës të cilat, rezultojnë të jenë aktivitete të formimit profesional, si dhe aktivitete ndërinstitucionale të tilla si, vizita studimore, mbledhje ekspertesh, tryeza të rrumbullakëta, etj. Konkretisht, gjyqtari ka qenë pjesëmarrës në aktivitete profesionale, në temat dhe datat si më poshtë:

- “Programi i partneritetit për drejtësinë gjyqësore dhe efikasitetin e administratës gjyqësore”, në datë 12-25 qershor 2016;

---

<sup>41</sup> Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitete të Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

- “Parandalimi dhe lufta ndaj korrupsionit në sistemin gjyqësor në vendet e Europës Jug-Lindore”, në datë 1-2 nëntor 2016;
- “Problematikat e sistemit penitenciar në Shqipëri”, në datë 2 korrik 2014;
- “Lufta kundër krimit kibernetikë dhe pornografisë së fëmijëve në internet”, në datë 15-16 janar 2014.

Sa më sipër, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në 14 aktivitete trajnuese, në programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 48 ditë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës penale dhe procedurale penale, gjithsej 14 aktivitete të zhvilluara për 48 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve 15-120 ditë duke u pikëzuar me 20 pikë.*

#### **4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, rezulton se ai është angazhuar në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit në 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit në 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

## KONKLZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitet trajnues si ekspert.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

### **4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtari lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtari brenda periudhës së vlerësimit (14.12.2015-12.12.2018) ka qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili në cilësinë e anëtarit ka marrë pjesë në mbledhjet e KLD të zhvilluara në periudhën e vlerësimit, duke marrë pjesë në diskutime lidhur me aktet nënligjore të miratuara. Gjithashtu, rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013-2016 të jetë angazhuar edhe në veprimtari të tjera ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë, siç janë pjesëmarrja në konferenca gjyqësore ndërkombëtare.

Konkretisht, me vendimin nr. 2171/3, datë 06.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është depozituar vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës “Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë” i datës 27.09.2014, ku gjyqtari {...}, është zgjedhur kryetari i bordit drejtues të kësaj shoqate, objekti i së cilës është të ndihmojë në rritjen profesionale të gjyqtarëve, si dhe rritjen e transparencës së gjyqtarëve përballë publikut, etj. Në kuadër të kësaj veprimtarie gjyqtari ka marrë pjesë në disa konferencën gjyqësore ndërkombëtare, si: i) koherenca e Këshillave Gjyqësore Europiane, zhvilluar në shkurt të viti 2016, në Paris, Francë; ii) kongresi vjetor i Shoqatës Europiane të Gjyqtarëve, zhvilluar në maj të viti 2015, në Gdansk, Poloni,; iii) kongresi vjetor i Shoqatës Ndërkombëtare të Gjyqtarëve, zhvilluar në nëntor të vitit 2015, në Barcelonë, Spanjë.

## KONKLUZIONI

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, duke vlerësuar jo anëtarësinë, por kontributin e gjyqtarit {...} si anëtar në KLD, në hartimin, diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore, si dhe angazhimin e gjyqtarit në veprimtari të tjera ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë në kuadër të drejtimit të “Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë”, për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.*

### 4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë kriter.*

Lidhur me këtë tregues, gjyqtari gjatë seancës dëgjimore paraqiti kundërshtimet e tij duke parashtruar se gjatë periudhës së vlerësimit ka qenë udhëheqës shkencor në temën e publikuar nga kandidati për magjistrati z.S.P., në botimin e Shkollës së Magjistraturës “Magjistrati VII”, botim i vitit 2014. Në mbështetje të këtij pretendimi gjyqtari paraqiti botimin “Magjistrati VII”, viti 2014.

Në përmbajtje të këtij botimi, evidentohet se gjyqtari ka qenë udhëheqës shkencor, i kandidatit për magjistratë, z.S.P. në temën “Konkurrimi i veprave penale. Probleme të praktikës gjyqësore në lidhje me të”, temë e cila është mbrojtur në datën 11.07.2012, vitit shkollor 2012-2013 dhe është botuar në vitin 2014. Edhe në rast se tema do të ishte realizuar gjatë periudhës së vlerësimit, sërisht nuk do të konsiderohej si publikim ligjor akademik i gjyqtarit, pasi gjyqtari në këtë rast nuk është në cilësinë e autorit të këtij botimi, por në cilësinë e udhëheqësit shkencor të kandidatit për magjistrat, e dhënë kjo që në rast se do të ishte brenda periudhës së vlerësimit (në rastin konkret i përket vitit 2012) do të afektonte vetëm treguesin disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për



gjqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve, tregues për të cilin gjyqtari është vlerësuar maksimalisht.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtarin {...}, ky tregues pikëzohet me 0 (zero) pikë.

#### **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

*Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	95

#### **NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

## SHTOJCA 1

### KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...} PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE			Piket total		Niveli i vlerësimit	
			100		Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Niveli	Piket	Të dhëna për metodologjinë		
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë	

					Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE</b>				<b>Piket total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Niveli</b>	<b>Piket</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	0-10 %	15	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	0-10 %	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë

	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<p><b>Koha mesatare:</b>  Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë  Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë  Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë  Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë  Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë</p>
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	+99%	10	<p><b>Tej standardit :</b>  Nën 81 % - 2 pikë  Mbi 81-87 % - 4 pikë  Mbi 87- 93 % - 6 pikë  Mbi 93-99 % - 8 pikë  +99% - 10 pikë</p>
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	<p><b>Koha mesatare:</b>  Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë  Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë  Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë  Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë</p>

					Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	b. Dosja e rivlerësimit; c. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	<b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	c. Dosja e rivlerësimit; d. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	Shumë e lartë	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	b. Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	b. Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarit :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	c. Dosja e rivlerësimit;	I pa konsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Piket total	Niveli i vlerësimit
				95	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia

<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparenca e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	15-120 ditë	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	trajnimin e gjyqtarëve				
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimi ligjore akademike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
<b>NIVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>		<b>SHKËLQYESHËM</b>			
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>		<b>395</b>			